



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-353/01-51652

Dt. 12.09.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, duke vendosur sipas kërkesës së CASAITALIA SH.P.K. me seli në Lubizhdë e Prizrenit ka kërkuar leje për ndryshimin e Vendimit të Lejes Ndërtimore të objektit- Afarist në kuadër të ngastrës kadastrale me nr.P-71813046-01122-1 Z.K.Lubizhdë, konform 57 në bazë të nenit 3 alinea 1 pikat 1.7, 1.17. dhe nenit 5 alinea 1 pika 1.1 neni 14 alinea 1. Pika 1.1 nenin 15 alinea 1 pika 1.1, neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013, si dhe konform neneve 14,15,16,17,19 dhe 19 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, si dhe konform nenit 4 pika 6.1, paragrafi 2, dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27 dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, bie këtë:

AKTVENDIM

- I.** Aprovohet kërkesa e parashtruar nga CASAITALIA SH.P.K. me seli në Lubizhdë e Prizrenit për ndryshimin e projektit të objektit – **Afarist-depo** në kuadër të ngastrës kadastrale P-71813046-01122-1 ZK. Lubizhdë.
- II.** I lejohet CASAITALIA SH.P.K. ndryshimin e projektit për objektin – Afarist-depo në kuadër të ngastrës kadastrale P-71813046-01122-1 Z.K. Lubizhdë, përkatësisht në sipërfaqe bruto të përdhese S= 2670.12m² (sipas Vendimit nr.04-351/02-01122-1 dt.13.04.2023) në sipërfaqe të përdhese S=2157.92, ndërsa një pjesë (konform projektit të prezantuar) është suteran me sipërfaqe bruto S=395.50m² me sipërfaqe bruto të tërësishme S=2553.42m².
- III.** Ndryshohet pjesërisht vendimi për leje ndërtimore me nr.04-351/02-32937 të dt.13.04.2023, sa i përket dispozitivit të vendimit lidhur me sipërfaqen bruto S=2670.12m² dhe etazhitet të objektit ku është P+0 e tash në etazhitet S+P(në bazë të projektit të prezantuar).



IV. Pjesa tjetër e Vendimit për leje ndërtimore me nr.04-351/02-32937 të datës 13.04.2023 mbetet e pandryshuar

A r s y e t i m

Parashtruesi i kërkesës CASAITALIA SH.P.K. me seli në Lubizhdë pranë shërbimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapsinor në komunën e Prizrenit, ka paraqitur kërkesë me nr.04-353/01-51652, me të cilën ka kërkuar leje për ndryshimin e projektit për objektin –Afarist depo sipas lejes së lartëcekur.

Në bazë të dokumentacionit ,të cilin e posedon DUPH-ja përkatësisht Vendimit me nr.04-351/02-32937 të datës 13.04.2023, parashtruesit të kërkesës CASAITALIA SH.P.K. me seli në Lubizhdë i është lejuar ndërtimi i objektit – Afarist depo në kuadër të ngastrës kadastrale P-71813046-01122-1 Z.K.Lubizhdë.

Sa i përket kërkesës me nr.04-353/01-51652 DUPH-ja vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke e aprovuar kërkesën e aplikuesit për ndryshimin e projektit të objektit – Afarist depot, si dhe në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi i është lejuar parashtruesit të kërkesës CASAITALIA SH.P.K. me seli në Lubizhdë ndryshimin e projektit për objektin në ng.kad.P-71813046-01122-1 ZK.Lubizhdë përkatësisht të etazhitet nga P+0 në etazhitet S+P+0, pasi që në bazë të inqizimit të gjendjes faktike në teren nga gjeodeti i licencuar Luan Abazi me nr.të licencës 129, të prezantuar nga ana e aplikuesit është konstatuar se është bërë ndërtimi-ndryshimi i projektit ,i cili gjindet në kuadër të ngastrës kadastrale P-71813046-01122-1 me sipërfaqe bruto të objektit $S=2553.42m^2$ e me etazhitet S+P+0.


Duph-ja vendos si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi , sipas të cilit është lëshuar leja ndërtimore me nr 04-351/02-32937 dt.13.04.2023 kurse sa i përket pjesës tjetër të vendimit për leje ndërtimore mbetet i pandryshuar.

Nga se u tha mëlartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi


Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, me ankesë mund t'i drejtohet MMHI-së, përmes kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtor profesional:


Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

Drejtori:


Pranverim Berisha, jur.

